



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2021:223722

Datë: 05.02.2025

Numri i dokumentit: 06810339

P.nr.136/2023

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË/ DEGA NË MALISHEVË - DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM - DIVIZIONI PENAL, gjyqtari i vetëm gjykues Njazi Morina, me zyrtaren ligjore Alberitë Bibaj, në lëndën penale kundër të akuzuarit R.Z, nga fshati S., Komuna e Malishevës, për shkak të veprës penale pranimi i ryshfetit në sektorin privat në vazhdimësi nga neni 309 par.1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së, sipas aktakuzave të Prokurorisë Themelore në Gjakovë PP/II.nr.1091/2021 të datës 13.09.2023, jashtë seancës, **më 05 shkurt 2025 nxjerri këtë:**

A K T V E N D I M

HUDHET aktakuzat e Prokurorisë Themelore në Gjakovë PP/II.nr.1091/2021 të datës 13.09.2023, dhe **PUSHON** procedura penale për të akuzuarin **R.A.Z.**, i lindur më ..., me numër personal 1002814672, për shkak të veprës penale pranimi i ryshfetit në sektorin privat në vazhdimësi nga neni 309 par.1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së.

Për shkak të tërheqjes së Prokurorit të Shtetit nga ndjekja penale.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrën e mjeteve buxhetore te gjykatës.

Të dëmtuarit: B.X.K.nga fshati K., Komuna e Malishevës, E.N.V.nga fshati M., Komuna e Malishevës, dhe Q.R.B.nga fshati C., Komuna e Malishevës, për realizimin e kërkesave pasurore juridike udhëzohen në kontest civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë me aktakuzën PP/II.nr.1091/2021 të datës 13.09.2023, ka akuzuar R.Z, nga fshati S., Komuna e Malishevës, për shkak të veprës penale pranimi i ryshfetit në sektorin privat në vazhdimësi nga neni 309 par.1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së.

Prokurori i shtetit Qazim Xharra, me parashtresën për tërheqjen nga aktakuza PP/II.nr. 1091/2021 të dt. 25.11.2024, e protokolluar në Gjykatë më dt. 25.11.2024, ka deklaruar se: Me datë 07.09.2023 është arrit marrëveshja për pranimin e fajësisë me të pandehurin R.Z, në prezencë të mbrojtësit të tij, me ç' rast edhe sipas pikës nën II është rekomanduar dënim lidhur me veprën penale në shumë prej 2500-3000€ si dhe dënim me burg prej 1 viti i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri nuk kryen vepër tjetër penale për kohën e verifikimit prej 2 viteve.

Bazuar në aktvendimin PP/I.nr.145/2021 të datës 05.10.2021 cili si aktvendim i vetëm ka figuruar në shkresat e lëndës, dhe arritjes së marrëveshjes për pranimin e fajësisë, me datë 13.09.2023 është ngritë aktakuzë ndaj të pandehurit R.Z, për shkak të veprës penale Pranimi i Ryshfetit në sektorin privat në vazhdimësi nga nenin309 par.1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së. Me datë 06.09.2024 pranë Gjykatës Themelore në Gjakovë dega në Malishevë gjatë shqyrtimit gjyqësorë mbrojtësi i të pandehurit R.Z., avokat Bekim Kafexholli në faqen 3 të procesverbalit ndër të tjera ka theksuar se ” që në aktakuzë vërehet se të gjitha masat e fshehta të vëzhgimit dhe telekomunikimeve përpos raportit policorë i referohet një urdhri të gjyqtarit paraprake me nr. PPr.nr.7/2020... që shihet se numri i lëndës është i vitit 2020, ndërsa aktvendimi për fillimin e hetimeve është i vitit 2021. Duke pasa parasysh këtë fakt gjyqtari gjykues ka siguruar një kopje të aktvendimit për fillimin e hetimeve PP/I.nr.04/2020 të datës 22.01.2020, të cilën edhe ia ka dorëzuar prokurorit i cili ka prezantuar në shqyrtim gjyqësor. Nga prokurori i cili ka prezantua në shqyrtimin gjyqësorë të datës 06.09.2024 jam njoftuar lidhur me këtë fakt dhe pas analizimit të këtij procesverbali kam shikuar të gjitha shkresat e lëndës si dhe nga arkiva kam siguruar shkresa të lëndës nga të cilat rrjedhë kjo gjendje faktike:

I. Fillimisht me datë 22.01.2020 nën numrin e lëndës PP/I.nr.04/2020 është marr aktvendim për fillimin e hetimeve ndaj të pandehurit R.Z, për shkak të dyshimit të arsyeshëm se i njëjti në intervalin kohorë nga fillimi i muajit tetor të vitit 2019 në vazhdimësi deri më datë 06.01.2020 si pronarë i auto shkollës B.në Malishevë...i kërkon të dëmtuarit E.V... , me çka me këto veprime ka kryer veprën penale Pranimi i Ryshfetit në sektorin privat nga nenin309 par.1 të KPRK-së .

II. Nën shenjën PP/I.nr.145/2021 të datës 05.10.2021 për të njëjtën çështje dhe ndaj të pandehurit të njëjtë nga prokurori Ali Uka, është marr aktvendim për fillimin e hetimeve lidhur me veprën penale Pranimi i Ryshfetit në sektorin privat në vazhdimësi nga nenin309 par.1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së. Në përshkrimin faktik nën I të këtij aktvendimi theksohet se me datë të pacaktuar të muajit tetor të vitit 2019 i pandehuri në cilësi të instruktorit të auto shkollës B.i ka kërkuar të dëmtuarit E.V....., në përshkrimin nën II theksohet se me datë 05.05.2021 që ka të bëjë me të dëmtuarin B.K., në përshkrimin nën III theksohet se me datë 23.03.2021 që ka të bëjë lidhur me të dëmtuarin Q.B.dhe nën përshkrimin nën IV me datë 07.07.2021 që ka të bëjë me të dëmtuarin E.E.. Bazuar në aktvendimin për fillimin e hetimeve PP/I.nr.145/2021 të datës 05.10.2021 që ka të bëjë lidhur me të pandehurin R. Z.lidhur me veprën penale pranimi i ryshfetit në sektorin privat në vazhdimësi nga neni 309 par.1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së, në bazë të së cilës edhe është arrit marrëveshja për pranimin fajësisë e datës 07.09.2023 e më pastaj edhe është ngritë aktakuza e datës 13.09.2023, rezulton se e njëjta është ngritë brenda afatit ligjorë nga neni 234 par.1 të KPRK-së, që do të thotë brenda afatit prej 2 viteve.

Përfundimisht bazuar në aktvendimin PP/I.nr.04/2020 të datës 22.01.2020 afati i hetimit ka kaluar me datë 22.01.2022 deri sa ka qenë në punë pranë DKR-së, respektivisht tek prokurori Ali Uka, ky fakt vërtetohet nga shënimi zyrtarë i datës 30.03.2022 i cili është përpilua nga prokurori i DKR-së lidhur me pranimin e lëndëve, me rastin e pensionimit të prokurorit Ali Uka, ndër të tjera edhe të lëndës PP/I.nr.145/21 që ka të bëjë me të pandehurin R.Z, për shkak të veprës penale nga neni 309 par.1 të KPRK-së.

Duke pas parasysh të theksuarat me lart, bazuar në nenin 157 par.1 të KPRK-së rrjedhë se afati i hetimeve sipas aktvendimit fillestar PP/I.nr.04/2020 të datës 22.01.2020 ka kaluar me datë 22.01.2022 andaj për shkak të këtij fakti, Prokuroria e Shtetit TËRHIQET NGA NDJEKJA PENALE ndaj të pandehurit R.Z, për shkak të veprës penale Pranimi i ryshfetit në sektorin privat në vazhdimësi nga nenin309 par.1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së.

Meqenëse prokurori i shtetit Qazim Xharra është **TËRHEQUR** nga ndjeka penale për të akuzuarin R.Z, nga fshati S., Komuna e Malishevës, për shkak të veprës penale pranimit i ryshfetit në sektorin privat në vazhdimësi nga neni 309 par.1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së, gjykata tërheqjen e prokurorit nga ndjekja penale për të akuzuarin e ka konsideruar si tërheqje para fillimit të shqyrtimit gjyqësor dhe bazuar në nenin 287 par.1 të KPP-së, i cili thotë se: *“Prokurori i Shtetit mund të tërheqë aktakuzën para fillimit të shqyrtimit gjyqësor, nëse paraqet njoftimin për tërheqjen nga aktakuza. Në rast të tillë, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues, me aktvendim e hedh aktakuzën dhe e pushon procedurën penale”, e par.2 i të njëjtit nen i cili thotë se: “Aktakuza e tërhequr nuk mund të paraqitet sërish nga prokurori i shtetit”.*

Gjykata e ka hedhe aktakuzën PP/II.nr.1091/2021 të dt.13.09.2023 dhe ka pushuar procedurën penale për të akuzuarin R.Z, nga fshati S., Komuna e Malishevës, për shkak të veprës penale pranimit i ryshfetit në sektorin privat në vazhdimësi nga neni 309 par.1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së.

Vendimi që shpenzimet e procedurës penale të bijën në barrën e mjeteve buxhetore të gjykatës është marrë bazuar në nenin 453 par. 1 të KPP-së.

Vendimi për udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest civil, për realizim e kërkesës pasurore juridike, është marrë bazuar në nenin 462 paragrafi 2 të KPP-së.

Nga se u tha më lartë e duke u bazuar në nenin 51 dhe 287 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË/ DEGA NË MALISHEVË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM - DIVIZIONI PENAL
P.nr.136/2023, më 05 shkurt 2025

Zyrtarja ligjore,
Alberitë BIBAJ

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Njazi MORINA

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej tre (3) ditëve, llogaritur nga dita e pranimit të tij. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.